



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 698, datë 11.10.2006

PËR

DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE, JOPUBLIKE, “UNIVERSITETI POLIS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike, “Universiteti Polis”, shkolla ndërkombëtare e arkitekturës dhe e politikave të zhvillimit urban, në emër të shoqërisë “Universiteti Polis”, shpk, e cila do ta ushtrojë këtë veprimtari në qytetin e Tiranës.
2. Shkolla e lartë universitare, jopublike, “Universiteti Polis” përbëhet nga dy fakultete:
 - i) Fakulteti i Arkitekturë-Urbanistikës, me degën:
Arkitekturë-Urbanistikë 4 vite;
 - ii) Fakulteti i Planifikimit Urban, me degën:
Planifikim urban 4 vite.
3. Shkolla e lartë universitare, jopublike, “Universiteti Polis” do të ofrojë vetëm ciklin e parë të studimeve universitare, i cili është 4 vjet, dhe në mbarim të tij, do të japë diplomë universitare “Bachelor”, në titujt:
 - Arkitekt-urbanist;
 - Planifikues urbanist.

4. Shkolla e lartë universitare, jopublike, "Universiteti Polis" do ta fillojë veprimtarinë në vitin akademik 2006-2007 dhe do të ketë sistemin e studimeve me kohë të plotë.
5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të bëjë verifikimin e plotësimin të kushteve për fillimin e procesit mësimor. Ndryshimet në vendndodhje, stafin pedagogjik, planet dhe programet, si dhe në elementet e tjera, të miratuara, të bëhen me miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe të akreditimit të kurseve të studimit, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë në institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

**MINISTRI I ARSIMIT
DHE SHKENCËS**

GENC POLLO





FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.114

30 tetor

2006

VENDIM

Nr.698, datë 11.10.2006

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, JOPUBLIKE “UNIVERSITETI POLIS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Universiteti Polis”, shkolla ndërkombëtare e arkitekturës dhe e politikave të zhvillimit urban, në emër të shoqërisë “Universiteti Polis”, sh.p.k., e cila do ta ushtrojë këtë veprimtari në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Universiteti Polis” përbëhet nga dy fakultete:

i) Fakulteti i Arkitekturë-Urbanistikës, me degën:

Arkitekturë-Urbanistikë

4 vite;

ii) Fakulteti i Planifikimit Urban, me degën:

Planifikim urban

4 vite.

3. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Universiteti Polis” do të ofrojë vetëm ciklin e parë të studimeve universitare, i cili është 4 vjet, dhe në mbarim të tij do të japë diplomë universitare “Bachelor”, në titujt:

- Arkitekt-urbanist;

- Planifikues urbanist.

4. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Universiteti Polis” do ta fillojë veprimtarinë në vitin akademik 2006-2007 dhe do të ketë sistemin e studimeve me kohë të plotë.

5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të bëjë verifikimin e plotësimit të kushteve për fillimin e procesit mësimor. Ndryshimet në vendndodhje, stafin pedagogjik, planet dhe programet, si dhe në elementet e tjera, të miratuara, të bëhen me miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe të akreditimit të kurseve të studimit, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë në institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha